# A K T  T H E M E L I M I

Sot me date 19-1-96 une Servet Dedja me vullnetin tim te lire dhe me cilèsine themeluese te shoqerise private krijoj shoqerine private SHPK me emertimin "KURORA".Kjo shoqeri do te kete seline e saj ne qytetin e Gramshit dhe aktivitetin e saj privat do ta shtrij ne te gjithe teritorin e Gramshit dhe te Shqiperise.Kapitali fillestar i SHPK "KURORA" do te jete 100000 leke,kontribut i zotit Servet Dedja.

Objekt i veprimtarise se SHPK "KURORA" do te jete:

Studime e projektime urbanistike,ndertime industriale,banesa e ndertime te te objekteve te ndryshme turistike,bujqesore etj.,punime shtresa te rrugeve,ujsjellesa,kanalizime e impianteimpjante per prodhimin e materialeve te ndertimit,punime speciale e te tjera.

SHPK "KURORA" do te zhvilloj aktivitetin e saj me nje afat kohor mbi 10 vjet.Te gjithe te ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat jane pron e zotit Servet Dedja.

SHPK "KURORA" ZHVILLON AKTIVITETIN E SAJ TE MBESHTETUR NE LEGJISLACIONIN,ne baze te normave e standarteve te ndertimit dhe ne baze te statutit te saj.

Administratori i SHPK "KURORA" eshte zoti Servet Dedja.

O R T A K U  I  V E T E M

/Servet Dedja/

Servet Dedja
Sh Dedja

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA Nr. 559 Rj.
N. 101 kol.

## V E R T E T I M

Sot me daten 19-01-96 perpara meje noteres F. Shehu u paraqit personalisht zoti Servet Dedja i cili per identitetin e tij paraqiti leternjoftimin personal me nr. 303161,me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe me vullnetin e tij te lire firmos aktin e siperm dhe une noterja e vertetoj.

N O T E R E

PULLE TAKSE
10 LEKE
SHQIPERISE
NOTERE TIRANE

NOTERE PUBLIKE
FATMARA SHEHU
TEL 249 28
NOTERE TIRANE

## S T A T U T

## I SHOQERISE PRIVATE SH.P.K "KURORA"

Ne baze te aktit te themelimit te dates 19.01.1996 ortaku themelues Servet Dedja themeloj shoqerine private me emrin "KURORA"

EMRI QENDRA TERITORI

Neni 1

Emri i shoqerise private SHPK eshte "KURORA".

Neni 2

Selia e SHPK "KURORA" eshte ne qytetin e Gramshit.

Neni 3

SHPK "KURORA" do te shtrij veprimtarine e saj private ne te gjithe teritorin e Shqiperise.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se SHPK "KURORA" eshte:

Studime e projektime urbanistike,ndertime industriale,banesa e ndertime te objekteve te ndryshme turistike,bujqesore etj.,punime shtresa te rrugeve, ujsjellesa,kanalizime e impjante,impjante per prodhimin e materialeve te ndertimit,punime speciale etjera.

Neni 5

SHPK "KURORA" do te ushtroj veprimtarine e saj private me nje afat kohor mbi 10 vjet.

REPUBLIKA E SHQIPERISE FATMARA SHEHU NOTERE TIRANE

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali i SHPK "KURORA" si kapital fillestar perbehet me vleren 100000 leke.Ky kapital eshte kontribut i zotit Servet Dedja.Me zgjerimin e aktivitetit te SHPK "KURORA" kapitali fillestar mund te shtohet me vendim te zotit Servet Dedja.

Neni 7

Transferimi i kapitalit fillestar do te behet me vendim te ortakut themelues dhe me akt noterial.Pjeset e kapitalit themelues jane te transferueshme edhe ne rruge trasheguese.

Neni 8

Pjeset e kapitalit fillestar mund te transferohen edhe personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri.

Neni 9

Me miratim te ortakut themelues z.Servet Dedja ne kete shoqeri mund te pranohen edhe ortake te tjere te cilet do te bashkojne kapitalet e tyre ne kete shoqeri.

19. 01. 1996

ORGANIZIMI E DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 10

SHPK "KURORA" do te drejtohet prej ortakut themelues z. Servet Dedja.

Administratoret do te caktohen me vendim te z. Servet Dedja.

Neni 11

Administratori ka per detyre organizimin e drejtimin e shoqerise. Disponon firmen ne banke ne llogarine e shoqerise dhe merr persiper edhe problemet financiare.

Merr dhe jep hua,lidh kontrata me te trete per veprimtarine e SHPK "KURORA" me pronar te huaj e vendas.

Vendos per marrjen e largimin nga puna te te punesuarve,nxjerrjen e tyre ne asistence si dhe menyren e shperblimit te tyre.

Mban regjistrimin themeltar te punonjesve,evidenton punen e tyre dhe kur eshte resti merr masa disiplinore sipas ligjit ne fuqi dhe ketij statuti.

Cakton dhe jep lejen e zakoneshme te te punesuarve.

Ndjek ritmikisht aktivitetin e shoqerise,cakton ekspertin kontabel per kryerjen e llogarive te saj.

Kryen ne kohe dhe me cilesi te gjitha veprimet per likujdimin ndaj sistemit fiskal.

Neni 12

Ortaku themelues i kesaj shoqerie mund te caktoj si administrator edhe nje person te jashtem duke i caktuar pagen e detyrat e tij neperputhje me veprimtarine e SHPK "KURORA".

Neni 13

Administratori e humbet detyren e tij ne rastin e prishjes se shoqerise ose me vendim te ortakut themelues.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 14

Shoqeria perfaqesohet nga ortaku themelues z.Servet Dedja.Me vendim ka te drejte te autorizoj nje person tjeter te perfaqesoj SHPK "KURORA".

Administratoret kane kopetenca te zbatojne te gjitha urdherat e dhena nga ortaku si dhe te zbatojne detyrat sipas ketij statuti,aktit te emerimit ose procesverbalet e mbajtura midis tyre.

A S A M B L E J A

Neni 15

Asambleja eshte organi vendimor i shoqerise.Ajo perbehet nga ortaku themelues nga punonjes te tjere pa te drejte vote.

Neni 16

Asambleja si rregull thirret duke njoftuar 15 dite para mbledhjes duke treguar diten,oren dhe materialet qe do te trajtohen ne mbledhje.Ortaku ka te drejte te marre pjese ne vendime.

19. 01. 1996

Neni 17

Ortaku themelues ka te drejte te caktoj kontrollor eksperte per veprimtarine ekonomike financiare duke caktuar edhe pagat e tyre.

## BILANCI I TE ARDHURAVE

Neni 18

Veprimet e shoqerise mund te mbyllen me daten 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ortaku themelues,administratori dhe eksperti nxjerr bilancin kont bel te saj,rezultatin ekonomik te fitimit dhe humbjet sipas ligjit.

Neni 19

Te ardhurat do te realizohen nga veprimtaria ekonomoke e shoqerise. Cmimet,tarifat e sherbimit do te caktohen me vendim te ortakut themelues,si dhe ne perputhje me nommat e ligjet ne fuqi.

Neni 20

Te ardhurat neto te cilat do te rezultojne pas zbritjes se tatimit, fitimit,krijimit te fondeve te zhvillimit dhe detyrimet e tjera do te mbeten pasuri e ortakut themelues.

## MARDHENIET E PUNES

Neni 21

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontratave te punes.Per problemet qe nuk parashikohen ne kontrate zbatohen dispozitat ligjore per mardheniet e punes.

Neni 22

Shoqeria merr persiper te respektoi rregullat ne fuqi te punesimit te Sigurimeve Shoqerore per te gjithe punonjesit,kurse keta te fundit detyrohen te respektojne kete statut dhe ligjet ne fuqi.

Neni 23

Te punesuarit pergjigjen sipas ligjit dhe ketij statuti dhe per mosrespektimin e detyrave dhe demeve te shkaktuara,pergjigjen dhe nga ana disiplinore dhe materialisht.

Administratoret mbajne pergjegjesi penale e civile per kryerjen e detyrave te tyre.

Te gjithe te punesuarit jane te detyruar te ruajne sekretin e shoqerise edhe pas lergimit nga puna.

Neni 24

Shperberja e shoqerise behet ne cdo kohe dhe per cdo lloj shkaku. Menyra e likuidimit te shoqerise esht ne kopetence te ortakut themelues. Ai percakton nje ose me shume likujdatore per te nxjerre rezultatin e tyre.

Neni 25

Shoqeria private "KURORA" eshte person juridik i pavarur.Ajo ka te drejta e detyra per te cilat pergjigjet me ligjin "Per shoqerite tregtare" e Kodin Tregtar.

19. 01. 1996

Neni 26

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj private ne bazete tregut te lire.

Themeluesi i kesaj shoqerie ka derdhur kapitalin e vet me qellim qe te fitoj te ardhurat dhe te perballoj humbje deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Neni 27

Shoqeria private "EURORA" eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne gjykaten e rrethit Tirane.

Neni 28

Themeluesi i shoqerise me rastin e shtimit te ortakeve ka te drejte te bej ndryshim ne statut dhe te hartojne kontrata te perbashketa me ortake te tjere duke bere ndryshime ne kete statut te cilat duhet te regjistrohen ne regjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane.

Ky statut u hartua ne kater kopje njera prej te cilave qendron ne gjykaten e rrethit Tirane prane dokumentacionit formues te kesaj shoqerie.

ORTAKU THEMELUES

Servet Dedja

Servet Dedja

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA Nr. 560 Rep

N - 102 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 19-01-1996 perpara meje noteres F. Shehu u paraqit personalisht z.Servet Dedja per identetetin e tij u sigurova nga l leternjoftimi i tij personal me mr. 303161,me zotesi te plote juridike per te vepruar,i cili me vullnetin e lire firmos aktin e siperm dhe une noterja e vertetova.

19. 01. 1996

PULLE TAKSE

10 LEKE

RPSHQIPERISE

N O T E R E

NOTERE PUBLIKE
FATMARA SHEHU
TEL 249 28

REPUBLIKA E SHQIPERISE FATMARA SHEHU NOTERE TIRANE